

JORINA VERLI

**KRIZA EKONOMIKE BOTËRORE DHE REFLEKTIMI
NË RAPORTET POLITIKE DHE EKONOMIKE
ITALO-SHQIPTARE**

Ekonomia shqiptare gjatë viteve të para të Monarkisë, dukej në gjendje pak a shumë të mirë. Madje u krijua iluzioni se po shkohej drejt një gjendjeje të begatë. Që prej vitit 1927, Zogu u kërkoi italianëve një moratorium mbi shlyerjen e interesave vjetore të kredive të vitit 1925, si pjesë përbërëse e kërkesës së tij për nënshkrimin e Traktatit të Aleancës (Paktit të Dytë të Tiranës). Italianët u treguan të gatshëm të pranonin, të bindur për përfitimet që mund të nxirrnin prej paktit në fjalë, si dhe për faktin se kjo shtyrje në kohë e shlyerjes së borxhit do ta mbante Shqipërinë më gjatë të lidhur pas Italisë.¹ Roma synonte t'i përdorte huatë e saj si mjet presioni për t'i shkëputur sa më shumë konçesione politiko-ekonomike A. Zogut dhe sigurisht jo për të lehtësuar vështirësitë financiare të Shqipërisë.²

Zogu e ndjente edhe vetë se nuk po dilte shumë i fituar nga e gjithë kjo situatë, megjithatë nuk kishte zgjedhje tjetër. Shqipëria ishte e paaftë të paguante. Ai u shpreh për Musolinin, se e ndjente veten disi të mashtruar, pasi Shqipëria duke shtyrë në kohë afatin e pagimit, vërtet do të fitonte kohë, por do të paguante edhe më shumë para. Lideri fashist në një akt xhentilese vendosi të bënte disa ndryshime në kërkesat e Italisë, ndryshime të cilat më pas, do të binin sërish në kurriz të Shqipërisë, pas klauzolave ekuilibruese që do të përfshinin në marrëveshje nëpunësit italianë të financave. Në marrëveshjen përfundimtare theksohej se qeveria shqiptare do të vazhdonte të mos paguante deri në vitin 1930. Në vitin 1931, ajo do të paguante një milion franga ari. Në vitin 1932, 2 milion. Më pas gjatë periudhës 1932-1938, ajo do të ishte e detyruar të paguante gjashtë këstet vjetore, shlyerja e të cilave ishte shtyrë për shkak

¹ Bernd J. Fischer, *Mbreti Zog dhe përpjekja për stabilitet në Shqipëri*, Tiranë: Çabej, 2000, f. 177.

² Beqir Meta, *Politika tatimore e shtetit shqiptar 1925-1939*, Tiranë: Shkenca, 1999, f. 72.

të moratoriumit.³ Zogu doli i kënaqur nga kjo ujdi, për sa kohë perspektiva e shlyerjes së saj mbetej e largët. I pyetur nëse pagesa e dyfishuar e kësteve vjetore midis periudhës 1932-1938 (rreth 11 milion franga ari në vit, pra rreth një e treta e të ardhurës kombëtare shqiptare të vitit 1928) do të ishte një ngarkesë e rëndë për Shqipërinë, Zogu iu përgjigj se ai mendonte të vinte mënjane rreth 1,5–2 milion franga ari çdo vit si fond për t’i paraprirë momentit kur do të duhej të fillonte të shlyhej kredia. Çuditërisht, shifrat e Mbretit tingëllonin si tepër optimiste, po të kihej parasysh gjendja e përgjithshme e ekonomisë. Tabloja e përgjithshme ekonomike e vendit kishte marrë drejt përkeqësimit qysh prej vitit 1920.⁴ Pas vitit 1928, u duk qartë se kriza financiare e shtetit shqiptar ishte fenomen kronik dhe kishte tendencën të zgjerohej.⁵

Lidhja e ngushtë politike dhe financiare me Italinë, kishte rëndësi të madhe për Republikën dhe më pas për Monarkinë Shqiptare. Por vitet 1933-1935 ishin një përjashtim. Bashkëpunimi midis dy vendeve ndaloi. Qeveria e Romës ndaloi dhënien e parave në formën e huave dhe tërhoqi instruktorët e saj që ishin vendosur dhe jepnin ndihmesë në fusha të ndryshme në Shqipëri. Shpesh kjo periudhë shihet si një përpjekje e pasuksesshme e Mbretit Zog, për t’u çliruar nga vargonjtë e varësisë shumëplanëshe nga Italia, për t’u çliruar nga “dominimi imperialist i monedhës italiane”.⁶

Këtu do të paraqesim një këndvështrim disi ndryshe, i cili mbron idenë se interpretimi i marrëdhënieve italo-shqiptare gjatë viteve 1933-1935, ka qenë në rastin më të mirë i pjesshëm dhe mbase, edhe i gabuar. Largimi midis dy vendeve nuk ishte një revoltë spontane e Mbretit Zog, por më shumë një rezultat i llogaritjeve të bëra gabim.

* * *

Data 29 tetor 1929, e njohur në ekonomi edhe si “e Marta e Zezë”, është data e pranuar nga historianët e ekonomisë, si data e fillimit të “Depresionit të Madh”. Kolapsi i papritur i çmimeve në tregun e aksioneve të SHBA-ve, u përhap me shpejtësi nga njëri shtet në tjetrin, duke i bërë njerzit të dëshpëroheshin për humbjen e parave të tyre. Më

³ B. J. Fischer, *Mbreti Zog...*, f. 177.

⁴ *Po aty*.

⁵ B. Meta, *Politika tatimore...*, f. 42.

⁶ Iljaz Fishta, Veniamin Toçi, *Gjendja ekonomike e Shqipërisë në vitet 1912-1944, prapambetja e saj, shkaqet dhe pasojat*, Tiranë: 8 Nëntori, 1983, f. 194.

pas, fenomeni mori përmasa alarmante duke prekur të gjitha tregjet dhe ekonomitë. Zhvlerësimi progresiv i parasë dukej se ishte e pamundur të ndalej. Megjithatë kishte edhe optimistë, si John Rockefeller, i cili shprehej se “gjatë 93 viteve të jetës së tij” kishte njohur “vetëm prosperitet ekonomik” dhe e shihte gjendjen aktuale “si një stad kalimtar”. Në vende të ndryshme, kriza ekonomike zgjati jo njësoj. Pati vende që u ndoqën prej saj deri në fund të viteve 1930, madje edhe deri në mesin e viteve 1940. Megjithatë, periudha më e errët ka qenë ajo e viteve 1929-1933.⁷

* * *

Shqipëria është një ndër ato raste, ku kriza ekonomike botërore vazhdoi më gjatë se sa një 4 vjeçar*. Shenjat e para të saj u dukën në fund të vitit 1929, efektet u bënë të ndjeshme në fillim të vitit 1930, ndërsa në Shqipëri, kriza e arriti kulmin në vitin 1934.⁸ Arsyet ishin të kuptueshme. Shqipëria një vend i vogël, i varfër e i pazhvilluar, gjatë gjithë jetëgjatësisë së saj si shtet, që prej vitit 1912, kishte mbetur thuajse tërësisht pa mbështetje e pa aleanca në arenën ndërkombëtare.

Gjatë viteve 1920, sidomos pas vendosjes së Monarkisë “Parlamentare Demokratike” më 1928, vërejmë një orientim (pa pasur shumë mundësi zgjedhjeje) drejt Italisë. Një marrëdhënie dashuri-urrejtje, por mbi të gjitha interes, që gjithsesi nuk arriti të çrrënjoste nga vendi i vogël në brigjet lindore të Adriatikut, varfërinë, papunësinë, karakterin bujqësor të ekonomisë, zinë e bukës në rast thatësire apo të korrash jo të mira, mpleksjen e ekonomisë së tregut me mbeturinat feudale etj. Populli shqiptar, që ishte mësuar me mjerim dhe vështirësi, edhe këtë herë, i përballoi privacionet me stoicizëm.⁹

Kriza paralizoi industrinë, sidomos aktivitetet që ishin në duart e kapitalit shqiptar. Disa nga fushat e industrisë që u prekën ishin: industria e materialeve të ndërtimit, industria e përpunimit dhe prodhimit të duhanit, industria e prodhimit të pijeve alkolike dhe industria e blajës (të dyja këto u përpoqën të reagonin ndaj problemeve financiare duke u organizuar në kartele), industria e zhveshjes së orizit, industria tekstile,

⁷ Murray N. Rothbard, *America's Great Depression*, 5th Edition, Auburn, Alabama 2005, p. 209.

* Sipas Prof. Iljaz Fishtës: Kriza ekonomike në Shqipëri zgjati deri në mesin e vitit 1935.

⁸ I. Fishta, V. Toçi, *Gjendja ekonomike...*, f. 89.

⁹ B. Meta, *Politika tatimore...*, f. 66, 67.

industria e lëkurëve dhe e këpucëve, industria e prodhimeve artizanale etj.¹⁰ Përveç fushave të industrisë, kriza përfshiu bujqësinë dhe blegtorinë, ekonominë dhe financat, sistemin monetar dhe atë të kreditit. Një sërë ndërmarrjesh e shoqërisht falimentuan dhe të tjera u futën në vështirësi të mëdha ekonomiko-financiare.¹¹

Nga krahasimi i përfundimeve të autorëve të ndryshëm¹² del se kriza ekonomike botërore e gjeti Shqipërinë tashmë në krizë, ose minimalisht në kushte shumë të vështira ekonomike. Bilanci i pagesave ishte thuajse gjithnjë pasiv. Në një vend të falimentuar ekonomikisht dhe financiarisht, burimet e fundit të parave kishin filluar të shterronin me shpejtësi marramendëse. Fuqia blerëse ishte ulur dhe ekonomia vendase ishte e paaftë të përballonte konkurrencën e produkteve të huaja të dyndura në tregjet lokale.¹³

Struktura e pashëndetshme ekonomike e mbajtur në këmbë me zor, kishte filluar të jepte rezultatet e saj negative. Shteti shqiptar vazhdonte të mbështetej në sistemin arkaik të taksave dhe tarifave doganore të konceptuara sipas sistemit fiskal turk. Ekzistonin akoma taksa mbi kafshët bujqësore dhe sistemi i së dhjetës, i cili u kërkonte fshatarëve të magazinonin prodhimin dhe të prisnin derisa të vinin tagrambledhësit e qeverisë për të marrë pjesën e tyre. Pikërisht, sistemi i së dhjetës gjatë viteve të krizës njohu një dështim të plotë.¹⁴

Statistikat e kohës tregojnë se 28% e të ardhurave shtetërore sigurohej nga veprimtaria ekonomike e popullsisë rurale dhe 76% e këtij 28% paguhej nga fshatarësia e varfër. Rreth 59% e të ardhurave shtetërore nxirreshin prej tarifave doganore. Ato nuk ishin ndërtuar që të inkurajonin biznesin, por kishin qëllim të vetëm të linin në arkën e shtetit sa më shumë të ardhura. Moszgjidhja e këtyre problemeve bëri që shifrat treguese për ecurinë e ekonomisë shqiptare të ngeleshin edhe në vitet 1930 të njëjta me ato të viteve 1920. Metoda e vjetër turke për të filluar çdo vit financiar me “zero”, pa mbajtur parasysh borxhet e vitit të

¹⁰ I. Fishta, V. Toçi, *Gjendja ekonomike...*, f. 89-100.

¹¹ B. Meta, *Politika tatimore...*, f. 63.

¹² Amadeo Giannini, *L'Albania dall'indipendenza all'unione con l'Italia 1913-1939*, 4^o edizione, Istituto per gli Studi di Politica Internazionale, Milano: 1940, p.179, 180; I. Fishta, V. Toçi, *Gjendja ekonomike...*, f. 88, 89; B. J. Fischer, *Mbreti Zog...*, f. 179, 180; etj.

¹³ I. Fishta, V. Toçi, *Gjendja ekonomike...*, f. 72.

¹⁴ B. Meta, *Politika tatimore...*, f. 77.

mëparshëm, i shtrembëronte të dhënat, duke i bërë ato në mënyrë fiktive më të pranueshme.¹⁵

Në vitet e krizës, ato që e thelluan edhe më tej gjendjen kritike financiare, ishin të prapambeturat aktive të shtetit, pra, shumat që kishin ngelur pa u arkëtuar nga tatimet dhe zëra të tjera të të ardhurave buxhetore, gjatë viteve të mëparshme.¹⁶

Viti financiar	Të prapambeturat aktive (në franga ari)
1930-1931	15.307.277
1934-1935	22.277.185

Në të njëjtën kohë dhe me të njëjtin ritëm, po rriteshin edhe të prapambeturat pasive të shtetit, pra, borxhet e shtetit ndaj të tretëve.¹⁷

Viti financiar	Të prapambeturat pasive (në franga ari)
1930-1931	11.652.505
1934-1935	22.299.768

Nga të dhënat e dy tabelave të mësipërme duket qartë se në vitin financiar 1934-1935, shteti kishte pothuajse dyfishin e borxheve për të marrë dhe për të dhënë, krahasuar me vitin 1930-1931. Mungesën e likuiditeteve dhe kolapsin financiar e raportonin edhe përfaqësuesit britanikë në Shqipëri: “Financat e vendit janë në një pozitë të pashpresë. Asgjë nuk po hyn në arkën e shtetit dhe nuk ka asgjë brenda në të... Zyrtarët civilë nuk janë paguar për muaj të tërë, tregtia ka ngecur.” Gjendja financiare ishte edhe më e rëndë se kaq, po të mbahen parasysht shumat e pashlyera të huasë SVEA.¹⁸

Në një memorandum të Lidhjes së Kombeve, që i referohej buxhetit shqiptar të viteve 1925-1931, vlerësohej se çdo vit financiar ishte mbyllur minimalisht me një defiçit prej 3 milion franga ari, për shkak se qeveria

¹⁵ B. J. Fischer, *Mbreti Zog...*, f. 178, 179.

¹⁶ B. Meta, *Politika tatimore...*, f. 69.

¹⁷ *Po aty*.

¹⁸ *Po aty*.

shqiptare bënte një vlerësim tepër optimist të shpenzimeve të veta dhe të mbledhjes së detyrimeve të prapambetura.¹⁹

Në ndryshim nga autorët shqiptarë si: I. Fishta, B. Meta etj., studiuesi amerikan B. J. Fischer është i vetmi, që i konsideron shifrat e të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë periudhës 1928-1936, jo shumë të cekuilbruara.

Viti financiar	Hyrje (në franga ari)	Shpenzime (në franga ari)
1928-29	28.700.000	28.200.000
1929-30	30.801.000	33.125.000
1930-31	29.818.000	31.655.000
1931-32	32.720.000	35.511.000
1932-33	37.334.000	37.699.000
1933-34	24.118.000	23.673.000
1934-35	18.507.000	18.888.000
1935-36	17.237.000	18.035.000

Ajo që vihet re nga tabela e mësipërme²⁰, është diferenca midis të ardhurave dhe shpenzimeve, gjithmonë në favor të këtyre të fundit. Pothuajse në çdo vit financiar, shpenzimet shtetërore i kanë kaluar të ardhurat e hyra në buxhetin e shtetit. Gjithashtu, vihet re që të dy zërat shkojnë drejt rënies, me thellimin e krizës në marrëdhëniet shqiptaro-italiane, e cila u shoqërua edhe me ndërprerjen e huadhënies nga ana e Italisë.

Një element tjetër që bie në sy, në shpenzimet e buxhetit të shtetit, përgjatë gjithë periudhës së paraqitur në tabelë, është se pjesën e luanit, rreth 45% - 50%, e merrnin shpenzimet për mbajtjen e ushtrisë dhe xhandarmërisë, të paraqitura në tabelën më poshtë, në zërin “Shpenzime për Ministrinë e Mbrojtjes” (në franga ari).²¹

¹⁹ Paskal Milo, *Politika e jashtme e Shqipërisë*, vëll.I, Tiranë: Toena, 2013, f. 797; B. J. Fischer, *Mbreti Zog...*, f. 179.

²⁰ I. Fishta, V. Toçi, *Gjendja ekonomike...*, f. 110, 111; B. Meta, *Politika tatimore...*, f. 68; B. J. Fischer, *Mbreti Zog...*, f. 179.

²¹ I. Fishta, V. Toçi, *Gjendja ekonomike...*, f. 110.

	1929-1930	1930-1931	1931-1932	1932-1933	1933-1934	1934-1935	1935-1936
Min. e Mbrojtjes	15.403.000	14.365.000	14.886.000	14.224.000	9.985.000	7.814.000	6.715.000
Min. e Financave	4.898.000	5.502.000	6.224.000	4.758.000	4.056.000	3.529.000	3.640.000
Min. e Drejtësisë	1.309.000	1.206.000	1.208.000	1.218.000	986.000	793.000	815.000
Min. e Arsimit	3.638.000	3.569.000	4.123.000	4.598.000	3.113.000	3.013.000	2.878.000
Min.P.Brendshme	3.202.000	2.428.000	2.574.000	3.153.000	2.466.000	1.588.000	1.448.000
Min. P. Jashtme	976.000	849.000	903.000	850.000	696.000	482.000	447.000
M. P. Botorë	2.502.000	2.504.000	3.605.000	6.248.000	1.699.000	1.221.000	1.413.000
M. Ekonomisë	1.197.000	1.232.000	1.988.000	2.650.000	673.000	448.000	643.000

Përveç faktit që shpenzimet i tejkalonin të ardhurat dhe shumica e shpenzimeve nuk shkonte për zhvillimin e vendit, por për mbajtjen e ushtrisë dhe xhandarmërisë, problem tjetër shqetësues ishte diferenca e madhe midis nivelit të eksporteve dhe atij të importeve.

Tregtia e jashtme e Shqipërisë në vitet 1928-1935, vijoi të bjerë në vazhdimësi, derisa në vitin 1934, importet dhe eksportet kishin rënë në vlerën 30% krahasuar me ato të vitit 1929.²²

Viti financiar	Hyrje (në franga ari)	Shpenzime (në franga ari)
1928	32.312.000	14.694.000
1929	38.644.000	14.683.000
1930	33.289.000	12.352.000
1931	29.513.000	7.509.000
1932	22.814.000	4.500.000
1933	15.938.000	5.746.000
1934	12.333.000	4.284.000
1935	13.730.000	6.037.000

Në fushën e tregtisë së jashtme, Italia gjithmonë zotëronte mbi 50% të importeve dhe eksporteve shqiptare. Kjo sepse tashmë ishte bërë partneri i natyrshëm i Shqipërisë, gjithashtu sepse nëpërmjet presionit që kishte ushtruar pranë vendeve fqinje, kishte bërë që ato të rezervoheshin për lidhjen e marrëdhënieve tregtare me Shqipërinë.²³

Për pasojë, Shqipëria nënshkruante shpesh marrëveshje e koncesione me kapitalin italian në dëm të ekonomisë së saj kombëtare. Zogu përpiqej të reagoonte butë ndaj abuzimeve të shoqërive italiane, duke i trajtuar ato herë pas here, me të dërguarit e Romës. Në qershor 1929, ai u ankua tek Musolini se Banka Kombëtare nuk po plotësonte kërkesën e qeverisë shqiptare për prerjen e monedhave prej argjendi, si një masë që

²² *Historia e Popullit Shqiptar*, Vëllimi III, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: Toena, 2007, f. 294.

²³ P. Milo, *Politika e jashtme...*, f. 817.

ndihmonte që ky metal i çmuar të mos dilte jashtë Shqipërisë.²⁴ Qeveria shqiptare u konfliktua disa here edhe me SVEA-n, e cila favorizonte hapur shoqëritë italiane në punët botore, investonte fondet e huasë në objekte të dorës së dytë në kundërshtim me marrëveshjen dhe lejonte abuzimet e tyre.²⁵

Rasti më flagrant është marrëveshja me shoqërinë italiane AGIP (Agenzia Generale Italiana Petrolio), së cilës i njihej monopoli i importimit të produkteve të naftës në Shqipëri, duke filluar prej korrikut 1929. Kjo marrëveshje jo vetëm që përbënte një humbje të madhe për ekonominë shqiptare, por në të njëjtën kohë, rrethanat në të cilat u nënshkrua, tregojnë papërgjegjshmëri fiskale nga ana e qeverisë së A. Zogut. Negociatat u zhvilluan keq. Fillimisht ato u karakterizuan nga vonesa dhe më në fund u mbyllën me një nxitim të jashtëzakonshëm, pa i dhënë mundësi konkurrencës së huaj të përgatiste ofertat e saj. Gjatë 6 javëve të bisedimeve nuk u mor asnjë masë për furnizimin e Shqipërisë me karburant, gjë që solli pezullimin e plotë të sistemit të transportit, madje edhe pezullimin e rrjetit postar. Më në fund, kur furnizimi mbërriti në Shqipëri, ai ishte i pamjaftueshëm dhe u lejua të binte në duart e spekulatorëve, të cilët nxorrën prej tij fitime të mëdha. Përkundrazi një shume prej 1,8 milion franga ari në vit, për një periudhë 30-vjeçare, Zogu kishte vënë në duart e një shoqërie të huaj, e cila ndër të tjera nuk zotëronte burime naftë të vetat, mundësinë e paralizimit të transportit në Shqipëri në çdo moment. Në atë kohë, në Shqipëri nuk kishte rrjet hekurudhor, pra transporti rrugor ishte e vetmja mënyrë transporti. Kushdo që kontrollonte monopolin e naftës, mund të kontrollonte edhe krejt transportin e vendit. Për më tepër, pas nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje, të gjithë kompanitë shqiptare që merreshin me importimin e naftës, automatikisht falimentuan.²⁶

“Thembra e Akilit” e qeverisjes së A. Zogut ishte paraja. Në kushtet e një pamjaftueshmërie financiare konstante, Mbreti rrallë refuzonte paratë e fituara lehtë përmes konçesioneve.²⁷ Si pasojë, gjendja e tregtisë me jashtë, vazhdoi për shumë kohë të mbetet në një kaos të vërtetë.²⁸

²⁴ *Po aty*, f. 795.

²⁵ *Po aty*.

²⁶ B. J. Fischer, *Mbreti Zog...*, f. 181.

²⁷ Misha Glenny, *Histori e Ballkanit 1804-1999, Nacionalizmi, luftërat dhe Fuqitë e Mëdha*, Instituti i Dialogut & Komunikimit, Tiranë: Toena, 2007, f. 420.

²⁸ B. J. Fischer, *Mbreti Zog...*, f. 181.

Për të lehtësuar kushtet e rënda ekonomike të vendit, Zogu përpunoi një varg programesh, përfshi këtu edhe një plan për pakësimin e shpenzimeve të ushtrisë (e cila, siç u përmend edhe më sipër, gllabëronte rreth 50% të buxhetit të shtetit). Qysh më herët sesa fundi i vitit 1931, kur i kërkoi Fejzi Alizotit një projekt-buxhet me shpenzime të kufizuara për Ministrinë e Mbrojtjes, Mbreti kishte shfaqur tendenca të kryente reduktime në këtë zë. Në vitin 1930, ai parashikonte të shkurtoje këmbësorinë nga 9 në 6 batalione. Më pas në vitin 1932, ky numër duhet të shkonte në 3 batalione. Në mënyrë të ngjashme do të shkurtohej edhe koha e shërbimit ushtarak (nga 18 muaj në vitin 1930, në 12 muaj në vitin 1931, në 6 muaj në periudhën e mëvonshme). Mbreti parashikonte shkurtime të konsiderueshme edhe në efektivat e artilierisë, si edhe të fuste në ushtrinë shqiptare njësitë e kavalerisë. Me këto masa, ai synonte krijimin e një ushtrie më kompakte, më të efektshme, më pak të kushtueshme, të organizuar për qëllime mbrojtëse. Kursimi vjetor që parashikohej nga këto ndryshime, duhej të ishte rreth 3 milion franga ari në vit, pra rreth 1/5 e buxhetit vjetor që i shkonte ushtrisë dhe xhandarmërisë.²⁹ Megjithatë, gjeneral Alberto Pariani, i cili po përpiqej me të gjitha forcat për konsolidimin e ushtrisë shqiptare, ndikoi pranë Ministrit të Jashtëm italian, që të mos realizoheshin reduktimet që Mbreti Zog dëshironte të kryente.³⁰ Në radhët e ushtrisë shqiptare ishin të punësuar mbi 2000 italianë dhe mbi 170 oficerë shqiptarë ishin specializuar në Itali.³¹ Mbreti u tregua i kujdesshëm për të mos zemëruar këta oficerë të punësuar në sajë të ndihmës italiane. Ata mund të ktheheshin kundër regjimit, ose të bashkoheshin me një opozitë, të cilën A. Zogu nuk do të mund ta kontrollonte.³²

Në momentet e nënshkrimit të Paktit të Parë dhe të Dytë të Tiranës, A. Zogu ishte ende i pasigurt për pozitat e tij brenda vendit, si pasojë i nevojitej mbështetja italiane për të qendruar në karrigen e pushtetit. Në vitin 1931, (atëherë kur refuzoi edhe përtëritjen e Paktit të Parë) pozicioni i tij ishte afirmuar, deri në pikën e vetëshpalljes dhe të qenit mbret. Prandaj aleancën me Italinë përpiqej ta ndërtonte në plan barazie, jo si një marrëdhënie vertikale protektorati, apo vasaliteti.³³

²⁹ *Po aty*, f. 187.

³⁰ Arben Puto, *Shqipëria politike (1912-1939)*, Tiranë: Toena, 2009, f. 485, 488.

³¹ *Po aty*, f. 488.

³² *Po aty*, f. 530.

³³ *Po aty*, f. 499.

Megjithatë Roma kishte në dorë valvolën e oksigjenit të shtetit shqiptar, financat. Sipas ministrit italian Soragna, Shqipëria ishte “një shtet me rrogë” dhe huatë që i akordoheshin, në fakt ishin “donacione”. Që në prill 1931, italianët, pasi ishin informuar për qëndrimin që kishte ndërmend të mbante Shqipëria në nëntor, bënë të qartë se të gjitha ndihmat financiare ndaj “aleates” së vogël do të ndërpriteshin, nëse Pakti nuk do të përsëritej. Ky kërcënim, nuk u mor parasysh nga Mbreti.

Duke pasur parasysh vlerësimet realiste të Soranjës lidhur me Shqipërinë dhe duke njohur vështirësitë e mëdha ekonomike në të cilat ndodhej vendi, Musolini vendosi të kërkonte sërish bashkimin doganor midis dy shteteve. Eqrem Libohova, i cili sapo kishte ardhur nga Italia, i dërguar aty për të negociuar për çështje financiare, garantoj Mbretin se pranimi i bashkimit doganor italo-shqiptar ishte zgjedhja e duhur.³⁴ Zogu qëndroi i palëkundur. Ai nuk mund të pranonte kërkesat ultimative të Duçes, pasi ato e vinin vendin në pozitë varësie të plotë. Këtu zënë fill përpjekjet për të gjetur një alternativë mbështetjeje ballkanike.³⁵

Hapat për një bashkëpunim ndërshtetëror, në vitet 1927-1928, kur gjendja e ekonomisë botërore dukej ende e kënaqshme, i kishte hedhur Pakti Briand-Kellogg, i nënshkruar në Paris nga ministri i Jashtëm francez A. Briand dhe Sekretari i Departamentit të Shtetit Amerikan, Kellogg. Thelbi i Paktit ishte përjashtimi i luftës si mjet për zgjidhjen e konflikteve dhe përdorimi vetëm i rrugëve paqësore. Në Pakt aderuan 57 shtete, por ai nuk solli ndonjë ndryshim në zhvillimin e ngjarjeve, veçanërisht në Europë.³⁶ Edhe Shqipëria aderoi në Paktin Briand-Kellogg³⁷, në momentin që vlerësoi mundësinë e lidhjes së marrëdhënieve diplomatike, me vende të tjera.

Por hapësirat e manovrimit dhe të politikës së pavarur të A.Zogut ishin të kufizuara. Fuqitë e Mëdha kishin njohur në vazhdimësi pozitën e veçantë të Italisë në Shqipëri. Nga ana tjetër Italia u kishte bërë të qartë

³⁴ Owen Pearson, *Albania and King Zog. Independence, Republic and Monarchy, 1908-1939*, Volume One, The Centre For Albanian Studies in association with I B TAURUS Publishers, New York: 2004, p. 340.

³⁵ Gazmend Shpuza, “Shqipëria dhe Konferencat Ballkanike”, *Kosova*, Nr. 20/21, Prishtinë 1998/1999, f. 93.

³⁶ Jean-Baptiste Duroselle, André Kaspi, *Historia e marrëdhënieve ndërkombëtare nga viti 1919 deri më 1945-ën*, Vëllimi I, Tiranë: LIRA, 2011, f. 115.

³⁷ Paskal Milo, “Shqipëria dhe Aleanca Ballkanike”, në: *Studime Albanologjike*, Tiranë: 1977, f. 59.

fuqive ballkanike e më gjerë se nuk do të toleronte të prekeshin interes e saj në Shqipëri.

Në këtë situatë Mbretit Shqiptar i mbetej të shfrytëzonte politikën momentale të Britanisë për ruajtjen e *status quo*-së në Mesdhe dhe sa të ishte e mundur edhe kontradiktat midis fuqive rajonale ballkanike ose midis tyre dhe Italisë. Dhe për lojën e tij brenda mundësive që ekzistonin ai është vlerësuar si një lojtar i shkathët.

